



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:079011
Datë: 14.05.2024
Numri i dokumentit: 05678841

PPP.nr.11/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Adelina Jusufi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores S. K.-B. nga P..., e përfaqësuar sipas autorizimit nga Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit, rr. “Nuhi Gashi”, lidhur me çështjen përmbarimore, për borxh, në bazë të dokumentit përmbarues – vendimit të Inspektoriatit të Punës, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për Lejimin e Përmbarimit P.nr.3290/20, i datës 16.12.2020, të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Afet Mjeku, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 14.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. **APROVOHET** prapësimi i debitorit Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit, rr. “Nuhi Gashi” ashtu që shfuqizohet Urdhri Përmbarimor P.nr.3290/20, i datës 16.12.2020, i lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Afet Mjeku, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

II. **ANULOHEN** të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në këtë çështje përmbarimore.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Zyra përbarimore e Përmbauesit Privat Afet Mjeku, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit për përbarim ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përmbaues, vendimi përmbaues i dhënë në procedurë administrative - vendimit të Inspektoriatit të Punës, i cili parashihet si dokument përmbaues në bazë të nenit 21 dhe 22 par. 1.2 të LPP-së.

Kundër Urdhrit për Lejimin e Përbarimit, brenda afatit ligjor, është ushtruar prapësimi nga debitori, në të cilin, ndër të tjera, ka theksuar se ndaj vendimit të Inspektoriatit është ushtruar ankesë dhe se duhet të pritët të shqyrtohet ankesa nga Inspektoriatit e se urdhër është lëshuar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, po ashtu se ka kundërshtuar pagesën për përpilimin e ankesës në procedurë administrative pasi që e njëjta është pa pagesë për palët, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoi prapësimin.

Kreditori, brenda afatit të caktuar ligjor, ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit duke e kundërshtuar në tërësi duke theksuar se shpenzimet i kërkon në bazë të Ligjit për Avokatinë, respektivisht nenit 21, par.1 të këtij ligjit, nenit 13, par.4 të LPP-së dhe nenit 49, par.1 të LPK-së, dhe ndër të tjera duke shtuar se pretendimet e debitorit se duhet të pritët vendimi i shkallës së dytë nuk duhet të merret për bazë, pasi që i njëjti nuk e shtyn ekzekutimin e tij, duke i propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin.

Gjykata, me aktvendimin PPP.nr.312/2021 të datës 14.05.2021 ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe ka lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr.3290/20, i datës 16.12.2020. Kundër këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila përmes aktvendimit Ac.nr.3997/2021 të datës 01.07.2022 ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit duke e kthyer çështjen në rivendosje në shkallën e parë me arsyet si në aktvendimin e mësipërm.

Gjykata në rivendosje, me aktvendimin PPP.nr.50/2022 të datës 12.09.2022 ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe ka lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr.3290/20, i datës 16.12.2020. Kundër këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila përmes aktvendimit Ac.nr.6352/2022 të datës 05.03.2024 ka aprovuar

si të bazuar ankesën e debitorit duke e kthyer çështjen në rivendosje në shkallën e parë me arsyet si në aktvendimin e mësipërm.

Gjykata pas kthimit të çështjes në rivendosje, ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit në prapësim dhe kreditorit në përgjigjen në prapësim si dhe shkresat tjera të lëndës, dhe gjeti se prapësimi i debitorit duhet të aprovohet si i bazuar për këto arsye:

Dokumenti përmbarimor me të cilin është iniciuar procedura përmbarimore në këtë çështje juridike, përkatësisht Vendimi i Inspektoratit të Punës 01Nr./08-598/2020, i datës 19.05.2020, ku është obliguar debitori që të bëjë kompensimin në vlerë prej 50 % të pagës bazë në emër të shpërblimit jubilar dhe të kryej shpenzimet e procedurës për përpilimin e ankesës sipas tarifës së OAK-së, nuk është i përshtatshëm për përmbarim për faktin se ky vendim nuk përmban shumën e përmbushjes së detyrimit. Një vlerësim i tillë i gjykatës mbështetet në nenin 22, paragrafi 1, nën paragraf 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejme LPP), në të cilin është përcaktuar se dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative, por në nenin 27, paragrafi 1 të LPP-së është përcaktuar se çka konsiderohet dokument përmbarimor, dhe se: “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”. Duke vlerësuar se një dokument përmbarues duhet t’i plotësoi të gjitha këto kushte në mënyrë kumulative për të qenë i përshtatshëm për përmbarim, Gjykata, gjeti se Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin në këtë çështje përmbarimore në bazë të titullit përmbarues të lëshuar në procedurë administrative - Vendimi i Inspektoratit të Punës, mirëpo vendimi i tillë nuk mund të konsiderohet titull përmbarues, ngase në dispozitiv të këtij vendimi nuk është e cekur shuma e detyrimit, asht siç është përcaktuar në nenin 27, paragrafi 1 i LPP-së.

Gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit është i bazuar në nenin 71, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar njëri nga shkaqet e prapësimit, dhe atë se: “dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë”, ngase Urdhri Përmbarimor në këtë çështje përmbarimore është lejuar pa u plotësuar kushtet ligjore, pra titulli ekzekutiv mbi bazën e të cilit është parashtruar propozimi për përmbarim, gjegjësisht Vendimi i Inspektoratit të Punës 01Nr./08-598/2020, i datës 19.05.2020, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë sepse nuk përmban shumën e detyrimit që duhet ekzekutuar.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 13 të LPP-së.

Nga arsyet e lartcekura dhe në bazë të nenit 73 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

PPP.nr.11/24 të dt.14.05.2024

**Gjyqtarja,
Adelina Jusufi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën